



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 07.03.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KAPANON INDUSTRIAL
PËR AKTIVITET PRODHIMI 1 DHE 2 KATE” ME VENDNDODHJE NË
AUTOSTRADËN TIRANË – DURRËS, KM 5, KASHAR, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt kërkues shoqërinë “Albaco Shoes” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kapanon Industrial për aktivitet prodhimi 1 dhe 2 kate”, me vendndodhje në Autostradën Tiranë – Durrës, Km 5, Kashar, Bashkia Tiranë, me subjekt kërkues shoqërinë “Albaco Shoes” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) konvertimin e kategorisë së tokës nga “Arë” në “Truall”;
 - b) miratimin nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik;
 - c) miratimin e lidhjes me infrastrukturën ekzistuese rrugore;
 - d) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


K R Y E T A R I

E D I R A M A

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËRI I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

